



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1514/1 prot.

Tiranë, më 18. 11. 2024

V E N D I M

Nr. 281, datë 18. 11. 2024

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në ligjin 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,² mori në shqyrtim ankesën nr. 226, datë 05.11.2024, të paraqitur nga D. T., kundër Prokurorisë së Përgjithshme dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, me pretendimin për diskriminim *për shkak të gjendjes shoqërore*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit pala ankuese shpjegon ndër të tjera se: “...prej datës 01.02.2000, deri në datë 28.12.2023 kam ushtruar detyrën e prokurorit derisa me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe me vendim të formës së prerë, datë 18.07.2024 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (ende i paarsyetuar) jam shkarkuar nga detyra e prokurorit.

Në këto rrethana kam qenë në funksionin e magjistratit për më shumë se 23 vjet.

Grupi i magjistratëve janë shtuar si subjekt përfitues të pagesës kalimtare me ndryshimet e fundit në ligjin nr. 8097, datë 21.03.1996, “Për pensionet suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar.

Në nenin 7 të ligjit nr. 8097, datë 21.03.1996, të ndryshuar, parashikohet se: “Personat e grupit të dytë që përmenden në shkronjën ‘a’ të pikës 9 të nenit 1, **pas ndërprerjes së funksionit, u jepen dy paga mujore të funksionit dhe pas këtyre pagave marrin 40 përqind të pagës referuese bruto, për aq kohë sa kanë punuar në funksione të tilla, por jo më shumë se 1 vit nga momenti i largimit nga ky funksion**”

Në këto kushte, kam vlerësuar se meqenëse magjistratët përfshihen në grupin e dytë të subjekteve që parashikon ligji më takon pagesa kalimtare prej dy pagash mujore dhe 40 përqind të pagës referuese bruto të funksionit.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

Nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme më është refuzuar kërkesa me një arsyetim tërësisht të pabazuar në ligj, duke argumentuar se ndërprerja e funksionit konsiderohet vetëm për subjektet që janë në kushtet e mbarimit të statusit të magjistratit, si në rastin e daljes në pension, dhe jo për personat e shkarkuar nga detyra në kuadër të procesit të rivlerësimit.

Unë konstatoj se një arsyetim i tillë i mbivendoset subjektivisht akteve ligjore të posaçme dhe është haptazi diskriminues.

Pagesa kalimtare përben një përfitim suplementar që qëndron autonom pas ndërprerjes së funksionit shtetëror.

Legjislacioni ka përcaktuar qartë se e drejta e trajtimit me pagesë kalimtare lidhet ekskluzivisht me vërtetimin e kriterit të ndërprerjes së funksionit të magjistratit, dhe aplikohet, ratione temporis, prej momentit të shkëputjes nga funksioni zyrtar.

Në këtë ligj parashikohet vetëm fakti se pagesa kalimtare i jepet subjektit të cilit i është ndërprerë funksioni.

Ndërprerja e funksionit përmbledh çdo lloj shkak që subjektit ja ka bërë të pamundur vazhdimin e funksionit, dhe këtu përfshihet edhe shkarkimi nga detyra, arsytet shëndetësore dhe jo vetëm dalja në pension.

I vetmi kusht ndalues përcaktohet në pikën 11, neni 1 të ligjit 8097, datë 21.03.1996, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se dorëheqja, alternimi i funksionit titullar me anëtar brenda institucionit nuk konsiderohet ndërprerje e funksionit.

Ligji në fjalë nuk rregullon vetëm trajtimin e magjistratëve, por normon në tërësi trajtimin suplementar për të gjithë zyrtarët e lartë të shtetit shqiptar, pjesa më e madhe e të cilëve nuk gëzojnë statusin e magjistratit në funksionet përkatëse që ata kryejnë.

Për mua është e qartë se Prokuroria e Përgjithshme ka zhvlerësuar tërësisht qëllimin e ligjit të posaçëm, nëpërmjet të cilit garantohet trajtimi suplementar për funksionarët më të lartë të shtetit shqiptar.

Në sajë të qëndrimit paragjykes të organit epror, mua më është mohuar e drejta për përfitimin e pagesës kalimtare pasi kam shërbyer si magjistrat për më tepër se 23 vite në detyrë.

Për sa kam dijeni, rezulton se shumë funksionarë shtetërorë që janë subjekte të ligjit të posaçëm, si për shembull stafi politik i Kuvendit, Kryeministrisë, apo funksionarë të tjerë, kanë përfituar rregullisht trajtimin me pagesë suplementare edhe pasi janë liruar nga detyra me anë të urdhrat të titullarit të institucionit.

Qëndrimi i zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm nuk është koherent as me aspektin financiar për sa i përket kontributeve shoqërore, pasi evidentohet se gjatë gjithë periudhës që unë kam ushtruar detyrën, Institucioni i Prokurorisë ka derdhur rregullisht kontributet suplementare për llogarinë time.

Pra, organi epror nuk ka denjuar të konsiderojë kontributet në vlerë monetare që më janë mbajtur për 23 vite nga paga dhe kanë shkuar rregullisht për fondin e sigurimeve suplementare.

Në vazhden e këtij qëndrimi, Prokuroria e Përgjithshme ka paraqitur një argument tjetër të papranueshëm, ku shprehet se ligji synon t'u japë përfitime shitesë atyre kategorive të funksionarëve që i kanë shërbyer shtetit, dhe prokurorët të cilët shkarkohen për shkak të procesit të rivlerësimit, nuk konsiderohen se janë në kushtet e ndërprerjes së funksionit dhe si rezultat nuk duhet të përfitojnë nga pagesa kalimtare.

Arsyetimi i këtij institucioni është përsëri jashtë çdo logjike ligjore dhe shtetërore.

Unë kam ushtruar me dedikim detyrën e Prokurorit të Republikës për më tepër se 20 vite, kam përfaqësuar me vendosmëri akuzën e shtetit ndaj elementëve kriminal më të rrezikshëm të vendit, dhe kam përballuar i vetëm dy atentate të renda të kryera nga organizatat kriminale kundër pasurisë dhe familjes time.

Vendimmarrja e organeve të rivlerësimit për të më larguar nga detyra në përfundim të një procesi administrativ, kurrsesi nuk mund të ketë efekt prapaveprues për të zhbërë gjithë veprimtarinë dhe kontributin tim si prokuror në shërbim të shtetit shqiptar.

Gjithashtu, zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, në përmbajtje të shkresës dërguar prej saj, më ka komunikuar se edhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka udhëzuar Drejtoritë Rajonale se subjektet e rivlerësimit kalimtar, që janë shkarkuar me vendim të formës së prerë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, nuk janë subjekte përfituese të pagesës kalimtare.

Çmoj se praktika përjashtuese e ndjekur bashkërisht nga institucionet e sipërpërmendura është bazuar në gjendjen time shoqërore si magjistrat i larguar nga detyra në përfundim të procesit të rivlerësimit.

Në këto rrethana, jam gjendur në një pozicion thellësisht të pabarabartë krahasuar me magjistratët apo zyrtarët e tjerë të shtetit, të cilët gëzojnë të drejtën për trajtim suplementar.

Për sa më sipër, vlerësoj se kemi të bëjmë me një rast diskriminimi strukturor të plotë, pasi ndërkohë që pagesa kalimtare ju jepet të gjithë subjekteve të parashikuara në grupin e dytë të shkronjës “a” të pikës 9, të nenit 1, të ligjit për pensionet suplementare, nuk i jepet një magjistrati, me arsyetimin e gabuar se është shkarkuar nga detyra në kuadër të procesit të rivlerësimit...”

Sa më sipër, pala ankuese kërkon nga Komisioneri:

- Konstatimin e diskriminimit, në të drejtën për të përfituar pagesën kalimtare, për shkak të gjendjes shoqërore si magjistrat i larguar nga funksioni në përfundim të procesit të rivlerësimit, nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore.
- Prokuroria e Përgjithshme të marrë masa për miratimin dhe dhënien e pagesës kalimtare në masën e dy pagave mujore të funksionit të prokurorit, sipas parashikimeve ligjore në fuqi.
- Instituti i Sigurimeve Shoqërore të marrë masa për miratimin dhe dhënien e pagesës kalimtare në masën 40 përqind të pagës referuese bruto të funksionit të prokurorit, sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), garanton mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh. Në nenin 1 të LMD parashikohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat

e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”,* ndërsa në nenin 12, *“Ndalimi i diskriminimit”,* pika 1, shkronja “c”, të po këtij ligji, parashikohet: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.”*

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në vijim, pas regjistrimit të ankesës dhe gjatë shqyrtimit paraprak të saj, subjekti ankues, D. T., nëpërmjet e-mail-it datë 13.11.2024³, ka depozituar pranë KMD-së kërkesën për tërheqje nga ankesa e paraqitur pranë Zyrës së KMD-së, pasi do ta ndjekë çështjen në rrugë gjyqësore.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar përcaktohet: *“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.*

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.*

³ Depozituar në cilësi prove në dosjen e ankuesit, pranë KMD-së.

Në nenin 94⁴/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

Procedura administrative konkrete pranë Komisionerit, është iniciuar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, D. T., i cili, me anë të kërkesës të përcjellë me datë 13.11.2024, është tërhequr nga ankesa e saj pranë KMD-së.

Për rrjedhojë, bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, si dhe kërkesën për tërheqje nga ankesa të paraqitur nga ankuesi në datën 13.11.2024, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës me nr. 226 regj., datë 05.11.2024, të paraqitur nga ankuesi D. T., kundër Prokurorisë së Përgjithshme dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa dhe nuk identifikohet ndonjë interes publik që do të legjitimonte vazhdimin e procedurës, nga ana e këtij organi publik⁵.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 33, pika 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës me nr. 226 Regj., datë 05.11.2024, të paraqitur nga D. T., kundër Prokurorisë së Përgjithshme dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, pa një vendim përfundimtar për çështjen, për shkak se ankuesi është tërhequr nga ankesa pranë KMD-së.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Gjendja shoqërore)
(Fusha: Punësim)

⁴ “Tërheqja e ankesës”.

⁵ Për analogji citojmë disa vendimmarje të Komisionerit, si: Vendimet me: nr. 83, datë 09.06.2023, nr. 195, datë 09.10.2023, nr. 228, datë 06.11.2023, nr. 230, datë 07.11.2023, të KMD-së dhe nr. 223, datë 07.08.2024.